



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 10/2010

Prishtinë më 09.03. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion**

**Në mbledhje morën pjesë:** Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Sala Berisha – Shala, Fatmir Rexhepi, Qamile Morina, Nerxhivane Dauti dhe Kaqusha Jashari.

**Munguan:** Slobodan Petroviq, Zef Morina dhe Múfera Şinik.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Bill Klawonn dhe Haxhi Gashi – USAID, Visar Ramaj – KDI, Nora Sahatçiu dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent.

**Stafi Mbështetës:** Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

**Mbledhjen e kryesoi :** Myzejene Selmani - kryetare

Në këtë mbledhje u propozua ky

**R e n d i d i t ë s :**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbajtur më 02. 03. 2010,
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale,
4. Të ndryshme.

**Kryetarja** - Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua me vërejtje.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 02. 03. 2010**

**Sala Berisha – Shala** – paraqiti vërejtje në pikën IV (katër) të rendit të ditës, te Rekomandimi, të zëvendësohen fjalët “*Kuvendi i Republikës së Kosovës*” më fjalën “*Komisioni*”.

*Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 02 .03. 2010 miratohet me vërejtjen e deputetes Sala Berisha - Shala.*

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale**

**Krytarja** – Theksoi se kryesuesja e Grupit të punës për Projektligjin nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale, Sala Berisha – Shala, i paraqet amendamentet për shqyrtim dhe hapi debat.

**Sala Berisha – Shala** – Si kryesuese e Grupit të punës për Projektligjin për miniera dhe minerale i paraqiti amendamentet e Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale. Ajo kërkoi që deputetët të kenë vëmendje të lartë gjatë shqyrtimit të këtyre amendamenteve, për shkak të rëndësisë së lartë të kësaj fushe që rregullon këtë projektligj dhe duke marrë parasysh, po ashtu, se Grupi punues merret që tre muaj me këtë çështje. Pastaj filloi me shqyrtimin dhe prezantimin e amendamenteve, nga neni 1 deri të neni 54, gjithsejtë 38 amendamente të propozuara nga grupi punues.

**Vërejtjet:**

#### ***Amendamenti 8***

Ndryshohet neni 13, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.5 dhe shtohet nënparagrafi 1.13.

**Ethem Çeku** – Propozoi që në nënparagrafin 1.1 “Kufiri të jetë 200 metra larg një fshati, qyteze, qyteti ose vendbanimi” dhe te nënparagrafi 1.2 të mbetet “ 100 metra larg ndonjë shtëpie brenda një zone, sikurse i propozuar në amendament”

**Kaqusha Jashari** – E përkrahu Çekun për ndryshimin e propozuar.

*Propozimet u miratuan njëzëri nga Komisioni.*

#### ***Amendamenti 11***

Ndryshohet neni 18 paragrafët 2, ( 2.1; 2.2; 3.2 ; 3.6.) 7, 8 dhe 9.

**Ethem Çeku** – Propozoi që në nënparagrafin 3.2 te Komisioni tenderues, që KPMM mos të jetë në përbërje në Komisionin tenderues, sepse është organ që jep licenca dhe paraqet konflikt të interesit.

**Sala Berisha - Shala** – Tha se në formë të shkurtër ka të drejtë Çeku, mirëpo nëse e shohim si tërësi, nuk ka të drejtë gjithnjë, duke iu referuar nenit 18 të Projektligjit. Në fund theksoi se për shkak të mbledhjes së të dhënave duhet patjetër të jetë pjesë e Komisionit tenderues edhe kryesuesi i KPMM - së.

**Fatmir Rexhepi** – Theksoi se këto ndryshime që po bëhen në Projektligj janë mjaft pozitive, mirëpo shfaqti shqetësimin se KPMM - ja këtu po implikohet në të dy rastet, edhe në procesin e dhënies së licencave edhe në procesin tenderues. Andaj, kërkoi që KPMM-ja të qëndrojë në fushëveprimin e vet, e jo edhe në proces të tenderimit.

**Kaqusha Jashari** – Shfaqti dilemën se a do të duhej të jetë pjesë e këtij procesi tenderues edhe KPMM - ja për shkaqe të njohurive profesionale, mirëpo duke përjashtuar konfliktin e interesit.

**Qamile Morina** – Tha se pasi që është theksuar në këtë paragraf që KPMM- ja është përfshirë të ofrojë informata, nuk e sheh të arsyeshme që kryesuesi i KPMM- së të jetë edhe pjesë përbërëse e Komisionit tenderues.

**Bill Klawonn (USAID)** – Nuk kishte përgjigje të saktë, mirëpo në parim tha se duke marrë parasysh që agjencitë e pavarura, si ZRRE- ja që duhet të punojë me direktiva të BE - së, thuhet që nuk duhet të përfshihet në proceset tenderuese, por në rregullatorin ligjor në fushën energjetike. Mirëpo shtoi se në këtë rast KPMM- ja nuk e rregullon pjesën ligjore, por MEM – i, d.m.th. është pozitë krejt tjetër. Ai propozoi që zgjidhja më e mirë do të ishte që KPMM - ja të jetë pjesë e Komisionit, por pa të drejtë vote.

**Fatmir Rexhepi** – Shtoi se nuk mund të vendosen paralele në mes të këtyre dy agjencive të pavarura, sepse rregullojnë fusha të ndryshme në fushëveprimin e tyre duke ritheksuar se agjencitë e pavarura nuk duhet të jenë pjesë e proceseve në autoritetin e tenderimit.

**Ethem Çeku** – Shtoi se pozita ose Qeveria nuk duhet t’i frikohet procesit të tenderimit në këtë komision. Sipas tij nuk ka ndonjë opozitë, për shkak se është e përfaqësuar nga ministrat e saj.

*Pas debatit të gjerë Komisioni votoi me rezultat 3 me 3 për heqjen e përfaqësuesit të KPMM - së ( nënparagrafi 3.2 hiqet) nga Komisioni tenderues dhe në vend të tij u miratua përfshirja e ministrit të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale.*

### **Amendamenti18**

Ndryshohet neni 30 nënparagrafi 1.1; 1.3 dhe 2.3.

**Ethem Çeku** – Sa i përket çështjes së kohëzgjatjes për shfrytëzimin e licencës për mineralet energjetike, theksoi se disa shtete e kanë të pakufizuar kohëzgjatjen e licencës, ndërsa disa shtete e kanë të kufizuar në mënyrë rigorozë, për shkak të jetës së teknologjisë. Ai iu referua rekomandimit të MEM - it që kjo licencë të jetë 40 (

katërdhjetë ) vjeçare, ndërsa ky paraqiti idenë e grupit punues që të jetë 30 (tridhjetë) vjet kohëzgjatja e licencës.

**Kryetarja** - Propozoi që kohëzgjatja e licencës për shfrytëzim për të gjitha mineralet energjetike të jetë 25 (njëzet e pesë) vjet, plus me mundësi vazhdimi me një vendim të posaçëm të Kuvendit.

**Sala Berisha - Shala** – Theksoi se në grup punues jemi pajtuar që kjo licencë të jetë 30 (tridhjetë) vjet, për shkak të jetëgjatësisë së termocentraleve.

**Fatmir Rexhepi** – Propozoi që ky afat të jetë sa më i vogël për shkak të mundësisë së investimeve të vazhdueshme dhe bëri thirrje që të kihet parasysh edhe shfrytëzimi i hapësirës gjeografike të vendit në mënyrë racionale.

**Qamile Morina** – u pajtua që koha të jetë sa më e shkurtë dhe pastaj të jetë mundësia e vazhimit të licencës, sepse sipas saj, nuk është e drejtë që sot të vendoset për një kohëzgjatje marramendëse për gjeneratat e ardhshme.

**Bill Klaëonn ( USAID)** – Bëri thirrje për kujdes kur të vendoset për këtë çështje, sepse investitorët e huaj, respektivisht të Termocentralit Kosova e Re, shpresojnë që licenca të jetë 40 (katërdhjetë) vjeçare. Dhe në rast se ky afat ndryshohet, është mundësia që ata investitorë të largohen.

**Kryetarja** – Për shkak të stërzgjatjes së mbledhjes dhe deri në harmonizimin e qëndrimeve, propozoi që të ndërpritet mbledhja dhe të vazhdohet në javën e ardhshme.

**Ethem Çeku** – Propozoi që kjo çështje të mbetet e hapur për shkak të ndjeshmërisë së saj dhe interesit vital të vendit, të fitohet kohë dhe në këtë rast të merren informata shtesë.

**Qamile Morina** – Duke iu referuar përfaqësuesit të USAID - it theksoi se është qasje e vështirë për shkak se Kosova nuk ka një ligj për koncesione energjetike me kriteret e përcaktuara. Po të ishte ky ligj, atëherë do të vendosej më lehtë.

**Kryetarja** – Sqaroi se çështja e minierave nuk hyn në pjesën e koncesionimit dhe partneritetit publiko - privat.

**Sala Berisha - Shala** – Shtoi se çështja e minierave nuk është e rregulluar me Ligjin për koncesionet, por do të vendoset me këtë ligj.

*Komisioni vendosi që kohëzgjatja e licencës për mineralet energjetike të jetë 30 (tridhjetë) vjet, plus 15( pesëmbëdhjetë ) vjet me mundësi vazhdimi.*

*Pas debatit Komisioni nxori këtë*

### ***Përfundim***

*I. Miratohen 38 amendamente të propozuara nga grupi punues, përkatësisht*

- gjerë te neni 54 i Projektligjit;*
- II. Procesverbalit i bashkëngjiten amendamentet nga neni 1 deri në nenin 54 të Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale.*

#### **4. Të ndryshme**

##### **a) Debati për Autostradën Morinë – Merdare**

**Kryetarja** – I njoftoi se ka ardhur një shkresë e datës 09. 03. 2010, nga Fatmir Limaj, ministër i MTPT - së, në të cilën propozohet që ministri është i gatshëm të raportojë para Komisionit për Autostradën Morinë – Merdare në datat 09,10 dhe 11 mars 2010, sepse në datat e tjera do të jetë i zënë me vizita jashtë vendit.

*Pas debatit Komisioni e nxori këtë*

##### ***Përfundim***

- I. Komisioni konstaton se nuk është çështje urgjente kërkesa e Ministrisë së Transportit dhe Post-Telekomunikacionit për të debatuar rreth Autostradës Morinë – Merdare;*
- II. Ministria e Transportit dhe Post -Telekomunikacionit do të ftohet në një takim të ardhshëm të Komisionit.*

##### **b) Mbledhja e radhës**

**Kryetarja** – Mbledhja e radhës do të mbahet më 16. 03. 2010. në të cilën vazhdohet me amendamentimin e Projektligjit për miniera dhe minerale.

Mbledhja përfundoi në orën 13: 00.

**E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

**Kryetarja e Komisionit**

---

**Myzejene Selmani**